



Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

3. KONCEPTET E PËRGJITHSHME DHE PËRSHKRIMI I TYRE

Konceptet për fushën *Gjuhët dhe komunikimi* të cilat janë zhvilluar në nivelin e parë dhe të dytë të arsimit vazhdojnë të zhvillohen dhe thellohen edhe në nivelin e tretë të arsimit, pra edhe në shkallën e pestë dhe të gjashtë të kurrikulës. Konceptet e kësaj fushe që zhvillohen edhe në këtë nivel të arsimit janë:

1. Tekstet letrare dhe joletrare

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë më të thelluara për tema, autorë, fenomene, dukuri dhe ngjarje të ndryshme letrare e kulturore. Kjo i mundëson nxënësit të konsolidojë të kuptuarit për tekstet letrare dhe joletrare dhe nëpërmjet tyre të dallojë veçantitë e strukturës gjuhësore, letrare e stilistike. Tekstet letrare dhe joletrare përdoren me nxënës për zgjerimin e dijeve dhe të aftësive argumentuese, interpretuese e kreative.

2. Gjuha figurative dhe jofigurative

Ky koncept përfshin njohuri të thelluara për gjuhën figurative dhe jofigurative, fantazinë krijuese

në zhanre të ndryshme dhe format e caktuara shprehëse. Trajtimi i kësaj tërësie në këtë nivel të arsimit, i mundëson nxënësit në zhvillimin e fantazisë krijuese në zhanre të ndryshme dhe në identifikimin e formave të caktuara shprehëse të cilat ndihmojnë krijimin e individualitetit.

3. Kritika, teoria, historia

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë më të thelluara për koncepte të kritikës, teorisë dhe historisë letrare. Nëpërmjet kritikës, teorisë dhe historisë, te nxënësi zhvillohen aftësitë për analizë dhe vlerësim të elementeve të teksteve të caktuara si personazhet, ngjarjet, individualitetet e modelet shprehëse, duke shpjeguar dhe debatuar mbi bazën e argumenteve për tema dhe autor.

4. Sistemi i gjuhës

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë më të thelluara për kategori gjuhësore nga

fushat e fonetikës, morfologjisë, sintaksës, stilistikës, leksikut dhe drejtshkrimit. Përvetësimi i sistemit gjuhësor realizohet përmes zhvillimit të shkathtësive të komunikimit që lidhen me forma të teksteve letrare dhe jo-letrare. Kjo i mundëson nxënësit që të pasuron fjalorin, zhvillon njohuritë për veçoritë fonetike, morfologjike, sintaksore e stilistike; përdor rregulla drejtshkrimore dhe zhvillon format të shkrimit narrativ, përshkrues e argumentues.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI
Shkalla kurrikulare 1
1. Të dëgjuarit dhe të folurit
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkëmben ide gjatë diskutimit, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur mimikën, fjalë dhe fjali të thjeshta; 2. Identifikon elementet kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta (ngjarjen, personazhet etj.), dallon gjuhën fgurative nga ajo jofgurative; 3. jep përshtypjen për një tekst të shkurtër letrar; 8. Përdor përvojat personale në bashkëbisedim; 4. Përdor përvojat personale që lidhen me shqetësimet, me interesat dhe me vetëbesimin e tij nëpërmjet bisedave dhe diskutimeve 5. Ndjek rregulla elementare dhe përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve, ekspozitave në klasë dhe paraqitjeve para ekranit. 6. Përcjell informacione nga mjete audio-vizuele (TV, kompjuter etj.)
2. Të lexuarit
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë si dhe elementet e përdorimit të gjuhës; 2. lexon me zë tregim të shkurtër dhe përdor pjesë plotësuese të tekstit (foto, vizatim etj.).

3. Zhvillon shkathtësitë për të lexuarit e kuptimshëm
4. Përfet apo parafrazon tekstet që ka lexuar;
5. Identifikon elementet kryesore të një teksti të shkurtër: ngjarjen, personazhet etj., dallon gjuhën figurative (metaforike) nga ajo jofigurative. jep përshtypje në lidhje me një tekst të shkurtër letrar a joletrar.
6. Identifikon të dhënat kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta.
7. lexon rregulla elementare dhe përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve, ekspozitave në klasë dhe paraqitjeve para ekranit;
8. lexon materiale të ndryshme nga mjete audio-vizuale

3. Të shkruarit

Nxënësi/ja:

1. Përshkruan tekste sipas modeleve dhe shkruan për të komunikuar idetë e veta me të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive dhe teksteve të shkurtra;
2. Praktikon teknika që janë specifike për krijime përkatëse dhe i përdor në aktivitete të caktuara;
3. Shkruan tekste shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;
4. Vizaton diçka të thjeshtë mbi bazë imagjinare dhe shkruan disa fjali për përmbajtjen e figurës që ka vizatuar;
5. Shkruan fjalët duke parë figura;
6. Shkruan fjali të thjeshta në kohën e tashme, të kryer dhe të ardhme;
7. Përdor drejt shkronjat e mëdha në fllim dhe përgjatë fjalisë;
8. Përdor drejt shenjat kryesore të pikësimit;
9. Përdor teknologjinë informative (për të shkruar fjalë, fjali, numra, simbole, tinguj, vizatime etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Shkalla kurrikulare 2

1. Të dëgjuarit dhe të folurit

Nxënësi/ja:

1. Përdor format më komplekse të gjuhës për të komunikuar me të tjerët për përmbajtjen dhe qëllimin e teksteve.
2. Identifikon pikat kryesore të bisedave të thjeshta dhe tregimeve që janë lexuar me zë, duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta. dëshmon prirjet e veta në lojërat skenike.
3. Interpretin tekste letrare, duke u nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve, rrëfimit, figurave.
4. dallon tekstin letrar nga ai joletrar;
5. Paraqet qëndrimin e tij nëpërmjet gjuhës dhe formave të thjeshta të komunikimit për çështje shoqërore që lidhen me interesat, me shqetësimet dhe me besimin e mjedisit ku jeton.
6. Ndjek rregullat e paraqitjes në organizimin e shfaqjeve të caktuara dhe përzgjedh punimet për to.
7. Interpretin idenë kryesore të një teksti duke e dalluar nga detajet.
8. Identifikon dhe përdor kategoritë gramatikore;
9. Përdor informacione nga mjete audio-vizuale (TV, kompjuter etj.)
10. Bën pyetje që lidhen me tekste të caktuara dhe të jep përgjigje përkatëse;

2. Të lexuarit

Nxënësi/ja:

1. Përdor strategji për të kuptuar materialet e lexuara letrare apo joletrare: poezi, prozë, letër, biograf, lutje, raport, reklamë etj.) duke identifikuar nivele të lexim-kuptimit dhe duke bërë dallimin e gjuhës figurative nga ajo jofigurative;
2. Identifikon pjesën themelore të ngjarjeve të tregimeve të lexuara me zë, duke përdorur fjalë të rëndësishme ose objekte vizuale (fotograf, vizatime etj.) si dhe Identifikon kategoritë gramatikore;
3. dallon tekstet letrare nga ato joletrare;
4. Interpretin vepra letrare, duke nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve,

rrëfmit, figurave, si: hiperbola, litota, metafora, dhe nxjerr një përfundim për tekstin letrar apo joletrar (për poezinë, tregimin, pjesën dramatike, raportin, reklamën, biografinë etj.).

5. Përdor strategjinë e lexim-kuptimit duke interpretuar idenë kryesore të një teksti dhe duke e dalluar atë nga detajet;

6. zhvillon aftësitë imagjinate dhe kreative;

7. Identifikon kategoritë gramatikore në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare.

3. Të shkruarit

Nxënësi/ja:

1. Praktikon formën e caktuar të një teksti letrar apo joletrar;

2. Zhvillon aftësinë e korigjimit të gjuhës së teksteve;

3. Shkruan një tekst të thjeshtë (ese, tekst të ndryshëm);

4. Shkruan lloje të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare, për tema të caktuara;

5. Shkruan për një situatë imagjinare;

6. Shkruan, sipas dëshirës apo me detyrë, tekste që promovojnë vlera të individit e të shoqërisë, lojës, ambientit, familjes, shkollës etj.

7. Përdor rregulla të drejtshkrimit; 8. Përdor drejt shenjat e pikësimit;

9. Përdor teknologjinë informative (kompjuterin, printerin) për të shkruar e vlerësuar një tekst, ngjarje, personazh e ide.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Shkalla kurrikulare 3

1. Të dëgjuarit dhe të folurit

Nxënësi/ja:

1. Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara a të prezantuara dhe reflekton për to.
2. Merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.
3. Interpreton subjektin, idenë, rrëfimin, gjuhën e figurshme, vendin e hapësirën në letërsi.
4. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme

2. Të lexuarit

Nxënësi/ja:

1. Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
2. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
3. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme
4. Pasuron fjalorin.

3. Të shkruarit

Nxënësi/ja:

1. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj.
2. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
3. Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara.
4. Shkruan për tema të caktuara;
5. Shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/a jo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime, vjersha etj.

6. Përdor materiale të ndryshme për të këmbyer porosi, nëpërmjet reklamave, shpalljeve, lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në medie.
7. Përdor teknologjinë për të krijuar tekste grafike, tabela, skica, figura, fotografi animacione, skeçe etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Shkalla kurrikulare 4

1. Të dëgjuarit dhe të folurit

Nxënësi/ja:

1. Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj.
2. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore
3. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme

2. Të lexuarit

Nxënësi/ja:

1. Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare.
2. Pasuron fjalorin.
3. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
4. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.
5. Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

3. Të shkruarit

Nxënësi/ja:

1. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj.
2. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të

shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

3. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët.

4. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit.

5. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie.

6. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Shkalla kurrikulare 5

1. Të dëgjuarit dhe të folurit

Nxënësi/ja:

1. Jep mendim për ide, tekste, autorë e subjekte të ndryshmeve.
2. Flet për krijimet artistike dhe vlerat e tyre.
3. Flet për formacione të ndryshme kulturore dhe letrare.
4. Kultivon ndjenjën për kulturë gjuhësore.
5. Flet për kulturat e ndryshme, për një periudhë të caktuar historike letrare.

2. Të lexuarit

Nxënësi/ja:

1. Kupton dhe analizon karakteristikat e gjinive e llojeve, letrare.
2. Analizon dhe vlerëson diskurset, stilin, gjuhën dhe qëllimin e teksteve.
3. Lexon dhe interpreton përmbajtjen e teksteve dhe konteksteve.
4. Njeh dhe interpreton autorë dhe dukuri letrare të periudhave të ndryshme.

3. Të shkruarit

Nxënësi/ja:

1. Përdor gjuhën për funksione të ndryshme gjuhësore dhe letrare.
2. Organizon idetë dhe përdor informatën për të krijuar forma të shprehurit me shkrim.
3. Shkruan tekste me temë të caktuar duke përdorur rregullat drejtshkrimore dhe stilin për funksione të ndryshme.
4. Analizon dhe interpreton stilin dhe format letrare dhe artistike tradicionale dhe bashkëkohore,
5. Krijon vepra më komplekse nëpërmjet gjuhës dhe shprehjeve artistike duke reflektuar kulturën, ndjenjat, emocionet, mendimet, idetë, pikëpamjet dhe përvojën për të shprehur qëndrimet për tema personale, globale e shoqërore.
6. Shkruan dhe organizon dhe prezanton tema të caktuara përmes medieve të ndryshme.
7. Përdor TIK-un për të lexuar, shkruar disenjuar dhe prezantuar tema të caktuara.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Shkalla kurrikulare 6

1. Të dëgjuarit dhe të foluri

Nxënësi/ja:

1. Jep mendim për tekste dhe autorë të veçantë.
2. Flet për stilin e teksteve të ndryshme.
3. Shpreh vlerësime për formacione të ndryshme kulturore dhe letrare.
4. Kultivon ndjenjën për kulturë gjuhësore dhe poetike.
5. Flet për kulturat e ndryshme, për një periudhë të caktuar historike letrare.

2. Të lexuarit

Nxënësi/ja:

1. Analizon dhe vlerëson informatat e nxjerra nga tekste komplekse letrare dhe joletrare dhe nxjerr konkluzione.
2. Analizon dhe vlerëson funksionin, stilin dhe gjuhën e teksteve.
3. Njeh dhe interpreton autorë dhe dukuri letrare të periudhave të ndryshme.
4. Njeh diskutet gjuhësore në funksion të atyre letrare.

3. Të shkruarit

Nxënësi/ja:

1. Analizon, vlerëson dhe interpreton tekste të zhanreve të ndryshme.
2. Shkruan për autorë dhe formacione të ndryshme kulturore e letrare.
3. Përshtat strategjitë dhe modelet e organizimit të shkrimit.
4. Shkruan tekste të caktuara për qëllim dhe publik të caktuar.
5. Analizon dhe interpreton stilin dhe format letrare dhe artistike tradicionale dhe bashkëkohore.
6. Përdor gjuhën dhe shprehjet artistike për të reflektuar kulturën, ndjenjat, emocionet, mendimet, idetë, pikëpamjet dhe përvojën për tema personale, globale e shoqërore.

7. Shkruan, organizon dhe prezanton tema të caktuara përmes medieve të ndryshme
8. Përdor teknologjinë (programe softuerike konvencionale) për të prodhuar krijime më komplekse në artet e ndryshme, si: video, animacion, reportazh, film dokumentar etj.